

STATUT I SHOQËRISE
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “EXPLO-CHEM INDUSTRIES” SH.P.K.

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, ndryshuar;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë “EXPLO-CHEM INDUSTRIES” SH.P.K.

KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më datë 13 Gusht 2024 unë Estela KONDURA, atësia Kostandin, datëlindja 22.03.1988, lindur ne Korçë dhe banuese ne Tirane, Rruga “3 Dëshmoret”, pall “Sina Konstruksion 2008”, Shk.1, Kati.8 Ap.36, me numër Personal I85322093C, madhor e me zotësi te plote juridike dhe zotësi te plote për te vepruar, me shtetësi shqiptare, në ora 13:00 vendos themelimin e Shoqërisë “EXPLO-CHEM INDUSTRIES” SH.P.K.

Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë “EXPLO-CHEM INDUSTRIES” SH.P.K. është: **Estela KONDURA.**

Neni 2

Selia

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rruga , Njësia Administrative Kashar, Apartament Yzberisht, ZK 3866, Nr. Pasurie 367/135+1-39, Tirane. Shoqëria mund të krijojë degë (filiale) ose përfaqësi, si në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë ashtu edhe në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

Shqipëri, numri i celularit për kontakt është +355696579234.

Adresa e email-it te shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është: estelakondura@gmail.com.

Neni 3

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

“Shoqëria merret me import, eksport, prodhimin dhe tregtimin e te gjitha llojeve te lendeve plasëse, për përdorim civil, sistemeve te ndezjes, detonatorëve dhe dinamiteve dhe te gjitha llojet e mjeteve dhe makinerive te lidhura me prodhimin e tyre si dhe siguron kontraktim te plasjeve dhe shërbimeve konsulencë. Shoqëria mund te ngrejë dhe mund te vere ne pune fabrika, kantiere si dhe stacione testimi dhe gjithashtu te transferoje këto ambiente dhe te ngrejë ambiente te lëvizshme, ajo mundet te tregtojë prodhimet e veta ne tregun vendas dhe te huaj, te blejë dhe te marre me qira ambiente, magazina dhe vende prodhimi nga personat e trete dhe Institucionet Shtetërore dhe t'i zgjeroje këto ambiente ne përputhje ne objektin e veprimtarisë se shoqërisë. Te hyje ne partneritet me shoqëritë e tjera apo individë brenda objektit te shoqërisë apo te behet ortak e veproje si përfaqësues ose te autorizojë përfaqësues dhe agjente si dhe te kontraktojë për këtu çështje. Te blejë nga furnizues vendas apo te huaj makineri dhe pajisje dhe/ose mjete materiale për te prodhuar këto makinerie pajisje, te cilat nevojiten për realizimin e objektivave ekonomike dhe aktivitetit operacional te shoqërisë. Te përfshihet ne aktivitet kërkimore, zhvillimi, trajnimi, planifikim-projektim-zbatim dhe te tjera aktivitete të ngjashme. Te blejë, te shes, ndërtojë, te japë e marre me kredi apo te përdorë me çdo mënyrë te ligjshme te gjitha llojet e pronave te luajtshme e te paluajtshme, te vendose pengje, hipoteka, uzufukte apo cdo barre tjetër ne pronat veta te luajtshme e te paluajtshme si garancitë detyrimeve te veta apo edhe te treteve. Te marre polica sigurimi për te mbuluar asetet dhe operacionet te veta. Te nxjerre,

 1

publikoje, shpërndajë revista, broshura, libra, cd dhe botime digjitale në lidhje me sektorin e vete dhe nëpërmjet shërbimeve të palëve të treta për këto botime. Te marre të gjitha llojet e kredive afat shkurtër, afat mesëm apo afat gjatë nga ente vendase apo të huaja me apo pa titull financiarë. Import-eksport, prodhim, tregtim, transshipin, ndërmjetësim dhe ekspozimin e të gjithë materialeve, produkteve dhe pajisjeve ushtarake, armatimeve dhe municioneve të gjitha modeleve dhe të gjitha llojeve të lejuara nga dispozitat e Legjislacionit aktual Shqiptar. Shoqëria mundet të merret me import, eksport, tregtime me shumicë dhe pakicë brenda vendit materialeve dhe produkteve, ushqimore, industriale, kimikate si dhe produktet e tjera. Projektme, studime fizibiliteti dhe ndërtime tunelesh, pusesh, minierash, objektesh industrial dhe jo-industrial. Kërkimi, zbulimi, shfrytëzimi dhe përpunimi i mineraleve të dobishme dhe tregtimi i tyre brenda dhe jashtë vendit. Import eksport, tregtim me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshme industriale, materialet e ndërtimit, produkteve bujqësore, blegtorale, ushqimore etj. Import dhe tregtim me shumicë pakicë të automjeteve dhe mjeteve minierash, ndërtimore të llojeve dhe tonazheve të ndryshme dhe pjesëve të këmbimit për to.”

Neni 4 Kohëzgjatja

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj pa afat të caktuar i cili fillon me regjistrimin e shoqërisë në Regjistrin Tregtar të QKB-se. Ortaku/et e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

Neni 5 Regjimi Juridik i Shoqërisë

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit. Ajo është një shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (Sh.p.k.). Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit tregtar e atij civil në fuqi. Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, Shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse. Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar. Shoqëria ka vulën e saj.

KREU II KAPITALI

Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 Lekë.

Ortaku themelues është Zj.Estela KONDURA: Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100,000 leke (njëqind mijë leke), që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakut të vetëm është në para që do të mbahet në arkën e shoqërisë.

Neni 7: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga QKB-ja kompetente e një eksperti kontributesh sipas kërkesës së administratorit.



Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e Ortak(eve), i cili merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit me 100% te votave.

Në të gjitha rastet, zvogëlimi prek ortakun në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqëson.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre, fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve (ortakut te vetëm ose ortakët te rinj qe mund te shtohen).

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakut/eve është aktualisht organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakut/eve është aktualisht organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakut/eve është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.



Neni 8

Të drejtat dhe detyrimet e Ortakeve

Ortakët japin kontributin e tyre në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë të gjithë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe, me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të rastit të sekretit tregtar, i cili është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria mbron, i cili në rast se do të përhapej personave të paautorizuar do të shkaktoje dëm të konsiderueshëm interesave tregtarë të shoqërisë. Ortakët kanë të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe të shesin pjesën e tyre të kuotave në përputhje me kushtet e përcaktuara në Statut dhe në ligj.

Neni 9

Largimi i ortakut nga shoqëria

Ortakët mund të shesin kuotat e tyre me pëlqim të organit drejtues të shoqërisë duke ofruar të drejtën e parablerjes ortakeve të tjerë të shoqërisë.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 80 (tetëdhjetë) për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me 100% (njëqindpërqind) të votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, hapjen e procedurave të falimentimit.



Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12

Përfshirja nga drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërseritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Emërohet si administrator i parë i shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit dhe specimenët e nënshkrimit:

Estela KONDURA me ID I85322093C.

Rruga “3 Dëshmoret”, pall “Sina Konstruktion 2008”,

Shk.1, Kati.8 Ap.36-Tirane

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratori/ët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecursisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratores janë të detyruar të thërrasin Asambleen e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërmdan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV VITI FINANCIAR-EKSPERTET

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertet

Eksperti, kur Shoqëria plotëson kushtet ligjore dhe statutore për të patur ekspert, ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollat periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakeve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollat periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohe ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KREU V PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë behet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese “ Shoqëri në likuidim e sipër”

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.



Neni 19

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.” ndryshuar.

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ndryshuar, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të treteve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

O R T A K U I V E T E M

E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

* “EXPLO-CHEM INDUSTRIES” SH.P.K. SH.P.K.*

Estela KONDURA

Estela Kondura
Ekluy